



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ___, datë ___/___/2026

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE AKSESIN NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, pika 4, të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi

1. Ky vendim përcakton rregullat për organizimin, funksionimin, administrimin dhe aksesin në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, si dhe për përpunimin, mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave që përmban ky regjistër.
2. Regjistri synon:
 - a) garantimin e një sistemi të unifikuar për identifikimin, referimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të fëmijëve në kujdes alternativ në familje;
 - b) mbështetjen e vendimmarrjes në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
 - c) sigurimin e gjurmueshmërisë së çdo mase të marrë për kujdesin alternativ;
 - ç) përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve.

Neni 2

Organizimi institucional

1. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje organizohet si pjesë përbërëse e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe në përputhje me parimet dhe rregullat e kuadrit ligjor në fuqi për funksionimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.
2. Baza e të dhënave të Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje administrohet dhe përditësohet nga Shërbimi Social Shtetëror, si institucioni administrues, në kuptim të legjisllacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, dhe aksesohet nga të gjitha njësitet e qeverisjes vendore në nivel bashkie e qarku
3. Përditësimi dhe hedhja e të dhënave në nivel vendor kryhet nga njësitet e vetëqeverisjes vendore.

4. Administrimi teknik i infrastrukturës kryhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Struktura e regjistrit**

1. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje shërben për:
 - a) Ndërtimin dhe funksionimin e një mekanizmi të integruar për menaxhimin e rastit, monitorimin dhe vlerësimin e rasteve të kujdesit alternativ në familje;
 - b) Identifikimin e rasteve, menaxhimin e tyre, këshillimin si dhe hartimin e planeve individuale të mbrojtjes dhe/ose kujdesit nga njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit/njësia për mbrojtjen e fëmijëve, në përputhje me ligjin për kujdesin alternativ në familje;
 - c) Referimin e rasteve në strukturat përgjegjëse të nivelit vendor, rajonal apo kombëtar;
 - ç) Lehtësimin e komunikimit, të verifikimit dhe bashkëpunimit me regjistrat e tjerë elektronikë;
 - d) Unifikimin, administrimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga sistemi;
2. Regjistri përbëhet nga module të integruara që përfshijnë:
 - a) të dhëna dhe dokumentacion për referimin e fëmijës për kujdes alternativ, familjet kujdestare, vullnetare dhe profesionale;
 - b) të dhëna dhe dokumentacion për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje;
 - c) të dhëna për llojin, kohëzgjatjen dhe statusin e kujdesit alternativ në familje;
 - ç) vendime administrative dhe gjyqësore që lidhen me rastin;
 - d) planin individual të kujdesit dhe/ose të mbrojtjes;
 - dh) raportet e monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit;
 - e) të dhëna për mbështetjen financiare dhe përfitimet përkatëse;
 - ë) historikun e plotë të rastit dhe statusin e tij.
3. Regjistri përmban dosjen elektronike të çdo rasti, në përputhje me modelin e regjistrit kombëtar të shërbimeve sociale.
4. Çdo përdorues i Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje pajiset nga institucioni administrues me “emrin e përdoruesit”, “fjalëkalimin” dhe me manualin për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin dhe përdorimin e këtij regjistri.

Neni 4 **Hedhja dhe përditësimi i të dhënave**

1. Të dhënat në regjistër hidhen dhe përditësohen në kohë reale ose brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore në zbatim të ligjit për kujdesin alternativ në familje, e në cdo rast jo më vonë se brenda 7 ditëve pune nga miratimi i tyre.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe shërbimet shoqërore, janë përgjegjëse për saktësinë, plotësinë, përditësimin dhe integritetin e të dhënave të regjistruara.
3. Përditësimi i të dhënave në regjistër kryhet në mënyrë të detyrueshme pas çdo:

- a) vendimi për vendosjen, ndryshimin ose përfundimin e kujdesit alternativ në familje;
- b) procesi monitorimi ose vlerësimi të rastit;
- c) ndryshimi në statusin e fëmijës ose të familjes kujdestare;
- ç) vendimi për përfitime financiare, sipas të dhënave të ndërlidhura me regjistrimin për ndihmën ekonomike, ose për masa të tjera mbështetëse;
- d) zhvillimi tjetër me rëndësi për ecurinë dhe menaxhimin e rastit.

Neni 5

Ndërlidhja me sisteme të tjera

1. Regjistri elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje ndërlidhet me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe sistemet elektronike në fuqi, përfshirë portalin e-Albania, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Regjistri Qendror i Llogarive Bankare (RQLLB) i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Sistemi elektronik për menaxhimin e kontributeve (CMIS), Regjistri Tregtar/eRegister i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas nevojës, me qëllim verifikimin, shkëmbimin dhe përditësimin e të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.
2. Ndërlidhja e sistemeve realizohet për të shmangur dyfishimin e të dhënave dhe për të garantuar saktësinë dhe integritetin e tyre, si dhe për të rritur efikasitetin e proceseve administrative dhe të menaxhimit të rasteve.
3. Rregullat e ndërveprimit zbatohen sipas modelit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për mënyrën e krijimit, administrimit dhe ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore.
4. Ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave shtetërore, që nuk janë të përcaktuara në këtë vendim, por që do të ngrihen me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave, proceset elektronike të punës në baza të dhënash të tjera të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe procedurat përkatëse realizohen në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi për bazën e të dhënave.

Neni 6

Përgjegjësit në proceset e punës

1. Përgjegjës për proceset e punës të lidhura me Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje janë:
 - a) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror;
 - c) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - ç) Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror;
 - d) Drejtoritë e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki ose struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore;
 - dh) Njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve në nivel vendor;
 - e) Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve;
 - ë) Institucionet e përkujdesjes shoqërore;
 - f) Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror;

2. Dhënës të informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror janë:
 - a) Familjet aplikante dhe/ose familjet e miratuara si familje kujdestare;
 - b) Prindërit biologjik nëse ka dhe fëmijët;
 - c) Punonjësi social i bashkisë/njesisë administrative/njesisë për mbrojtjen e fëmijëve;
 - ç) Menaxherët e rastit në njësitë vendore.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - a) regjistrojnë dhe përditësojnë të dhënat për rastet në juridiksionin e tyre;
 - b) sigurojnë dokumentimin e plotë të rasteve;
 - c) bashkëpunojnë me strukturat e tjera për verifikimin e të dhënave.
4. Shërbimi Social Shtetëror:
 - a) administron dhe konsolidon të dhënat në nivel kombëtar;
 - b) kryen analiza dhe harton raporte statistikore bazuar në të dhënat e plotësuara sipas formatit të paracaktuar;
 - c) monitoron përdorimin dhe funksionimin e regjistrit.
5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës:
 - a) përdor të dhënat e regjistrit për analizë dhe raporte në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Përmbajtja e Regjistrit

1. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje përmban të dhëna për familjet kujdestare dhe për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alterantiv në familje;
2. Të dhënat e regjistrit ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore.
 - 2.1 Të dhënat parësore janë të dhëna që administrohen nga njësitë e qeverisjes vendore, përmes strukturave përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe përfshijnë në veçanti:
 - a) të dhëna për rastet e referuara për përfitimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje;
 - b) të dhëna për përfituesit e shërbimit të kujdesit alternativ në familje;
 - c) verifikimin dhe administrimin elektronik të të dhënave të rastit të unifikuar të referuar;
 - ç) dosjen elektronike të rastit, e cila përmban të gjithë dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe dokumentet e skanuara nga formati fizik;
 - d) të dhëna mbi vendimmarrjen administrative dhe/ose gjyqësore për trajtimin e rastit;
 - dh) të dhëna mbi planin individual të kujdesit dhe/ose të mbrojtjes, si dhe zbatimin e tij, përfshirë, kur është e mundur dhe në interesin më të lartë të fëmijës, masat për mbështetjen e familjes biologjike, ruajtjen e kontakteve të sigurta me fëmijën dhe vlerësimin e mundësive për riintegrim familjar;
 - e) të dhëna mbi monitorimin, vlerësimin dhe ecurinë e rastit, nevojat sociale dhe psiko-sociale të fëmijës dhe familjes, si dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin dhe rishikimin e planit individual të kujdesit dhe/ose të mbrojtjes.
 - 2.2 Të dhënat dytësore janë të dhëna që sigurohen përmes ndërveprimit me baza të tjera të të dhënave shtetërore, dhe përfshijnë, ndër të tjera:
 - a) nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile:
 - i) numri personal i identifikimit (NID);

- ii) emri, atësia dhe mbiemri;
 - iii) gjinia;
 - iv) data e lindjes;
 - v) vendbanimi (në nivel bashkie);
 - vi) marrëdhënia me kryefamiljarin.
- c) nga sistemi i Regjistri Tregtar/eRegister i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas nevojës për verifikimin e të dhënave të lidhura me aktivitetin ekonomik të familjes kujdestare profesionale;
- ç) nga sisteme të tjera shtetërore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 5, të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e ndërveprimit të bazave të të dhënave.

Neni 8 Nivelet e aksesit

1. Përdoruesit e Regjistrit pajisen me kredenciale individuale dhe janë përgjegjës për përdorimin e tyre. Çdo veprim në sistem regjistrohet dhe është i gjurmueshëm.
2. Niveli i aksesit në Regjistrin Elektronik të Kujdesit Alternativ në Familje është si më poshtë vijon:
 - a) Njësitë dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë të drejtë leximi, shkrimi, vlerësimi dhe modifikimi në lidhje me rastet e fëmijëve në kujdes alternativ në familje, përfshirë planin individual të kujdesit dhe historikun e rastit, si dhe të plotësojnë, përditësojnë e modifikojnë planin individual të kujdesit dhe të regjistrojnë aktivitetet e ndërhyrjet e kryera në funksion të fëmijës;
 - b) Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë të drejtë leximi dhe vlerësimi, si dhe gjenerimi të listave të familjeve dhe të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në familje dhe raporteve periodike;
 - c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka të drejtë leximi dhe analizimi të të dhënave në nivel kombëtar, si dhe gjenerimi të raporteve statistikore dhe analitike;
 - ç) Ofruesi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje ka të drejtë leximi, vlerësimi dhe modifikimi mbi të dhënat e rasteve që ndodhen nën përgjegjësinë e institucionit të tij;
 - d) Inspektoriati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror ka të drejtë leximi dhe gjenerimi të të dhënave, për qëllime inspektimi dhe raportimi;
 - dh) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka të drejtë leximi dhe analizimi të të dhënave në nivel kombëtar, si dhe gjenerimi të raporteve dhe të dhënave për hartimin dhe monitorimin e politikave;
 - d) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka rol monitorues për Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë zbatimit të procedurës së procesit të kujdestarisë familjare.

Neni 9
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje përpunohen vetëm për qëllime të përcaktuara ligjërisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Institucionet përgjegjëse marrin masa të përshtatshme teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë, konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave, si dhe për mbrojtjen e tyre nga aksesit i paautorizuar, humbja apo dëmtimi.
3. Aksesit në të dhënat e regjistrit lejohet vetëm për përdorues të autorizuar, në përputhje me rolet dhe nivelet e aksesit të përcaktuara nga institucioni administrues.
4. Përdoruesit e autorizuar janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave dhe të mos i përdorin apo shpërndajnë ato për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara.
5. Përpunimi, shkëmbimi dhe publikimi i të dhënave realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijës.
6. Çdo shkelje e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale sjell përgjegjësi administrative, civile dhe/ose penale, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Raportimi

1. Shërbimi Social Shtetëror harton raporte periodike statistikore dhe analitike mbi bazën e të dhënave të regjistrit, në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar.
2. Të dhënat përdoren për:
 - a) planifikimin dhe hartimin e politikave në fushën e kujdesit alternativ në familje;
 - b) planifikimin buxhetor dhe shpërndarjen e burimeve financiare;
 - c) monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimeve;
 - ç) analizën e ecurisë së rasteve dhe rezultateve për fëmijët në kujdes alternativ;
 - d) mbështetjen e proceseve të deinstitutionalizimit dhe riintegritimit familjar;
 - dh) identifikimin e nevojave për zhvillim të shërbimeve dhe kapaciteteve institucionale.
3. Raportet hartohen në përputhje me formatet dhe afatet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e përfshira në sistem janë të detyruara të sigurojnë të dhëna të sakta dhe të përditësuara për qëllime raportimi.
5. Të dhënat e publikuara janë të agreguara dhe nuk përmbajnë të dhëna personale identifikuese, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11

Kontrolli

1. Funksionimi i Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje i nënshtrohet auditimit periodik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazën e të dhënave shtetërore.
2. Kontrolli përfshin:
 - a) verifikimin e saktësisë, plotësisë dhe përditësimit në kohë të të dhënave;
 - b) verifikimin e përputhshmërisë së përdorimit të regjistrit me legjislacionin në fuqi dhe këtë vendim;
 - c) kontrollin e respektimit të niveleve të aksesit dhe të gjurmueshmërisë së veprimeve në sistem;
 - ç) identifikimin e mangësive dhe rreziqeve në funksionimin e sistemit dhe në menaxhimin e rasteve.
3. Kontrolli kryhet nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe nga struktura të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Në rast konstatimi të mospërputhjeve apo shkeljeve:
 - a) merren masa korrigjuese nga institucionet përgjegjëse brenda afateve të përcaktuara;
 - b) mund të kufizohet ose pezullohet përkohësisht aksesit i përdoruesve që kanë kryer shkelje;
 - c) njoftohen autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas rastit;
 - ç) ndërmerren masa disiplinore ose administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Rezultatet e kontrollit dokumentohen dhe përdoren për përmirësimin e funksionimit të regjistrit dhe të cilësisë së shërbimeve të kujdesit alternativ në familje.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - a) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) Shërbimi Social Shtetëror;
 - c) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - d) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për administrimin teknik të sistemit;
 - e) Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
 - f) Institucionet e tjera të përfshira në sistem.
2. Rregullat për përdorimin e Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, përfshirë nivelet e aksesit dhe procedurat e operimit, përcaktohen në manualin e përdorimit të regjistrit, të miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Përdorimi i regjistrit fillon pas hartimit dhe zbatimit të modulit në sistemin e shërbimit social.

3. Përdorimi i regjistrit fillon pas hartimit, testimit, miratimit dhe vënies në funksion të modulit përkatës në sistemin elektronik të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe pas sigurimit të kushteve teknike dhe organizative për përdorimin e tij nga institucionet përgjegjëse.
4. Personat përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi trajnohen nga Shërbimi Social Shtetëror për përdorimin teknik të sistemit, hedhjen dhe përditësimin e të dhënave, përpunimin e raporteve, dokumentimin profesional të rastit, mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin e regjistrit në funksion të menaxhimit të rastit dhe monitorimit të cilësisë së kujdesit alternativ në familje.
5. Administrimi dhe përditësimi i të dhënave kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me këtë vendim.
6. Administrimi teknik i infrastrukturës hardware dhe software të sistemit kryhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Institucionet përgjegjëse (përdorues të sistemit) sipas roleve të tyre, janë të detyruara të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat brenda afateve të përcaktuara, në përputhje me këtë vendim dhe aktet nënligjore në fuqi.
8. Institucionet që administrojnë baza të tjera të dhënash shtetërore sigurojnë shkëmbimin e të dhënave të nevojshme, në përputhje me legjislacionin për ndërveprimin e sistemeve dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe vënies në funksionim të Regjistrat Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA